



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272792  
Datë: 18.04.2024  
Numri i dokumentit: 05590911

**AC-I-23-0242**

**Në ankesën e**

**Paditësi/Ankuesi**

**A K**, fshati L i P, Podujevë.  
Përfaqësuar nga **Avokat B I**, Prishtinë.

**Kundër**

**E paditura**

**NSH "Eximkos", (në likuidim)** Prishtinë, përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-2115 (2022:272792) të datës 04 prill 2023, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-2115 i datës 04 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 03 dhjetor 2015, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN092-0160 të datës 28.08.2013, me të cilën ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 1990-1999 në shumë prej 27,641.95 euro, si e pavlefshme me arsyetimin se e njëjta është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Paditësi ka pohuar se ka qenë në marrëdhënie pune deri në ditën e privatizimit me datë 04.02.2006, dhe sipas tij kjo vërtetohet nga njoftimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 01.06.2006 dhe listës së 20%. Paditësi tutje ka pohuar se me datën 01 qershor 2006, ka pranuar njoftimin e AKP-së me të cilin njoftohet se marrëdhënia e tij është ndërprerë menjëherë, po ashtu është njoftuar se çdo kërkesë duhet ta paraqes në procedurën e likuidimit të ndërmarrjes, dhe me këtë njoftim është ndërprerë parashkrimi. Me datën 16 gusht 2007 është publikuar njoftimi nga AKP se të gjithë kreditorët mund të paraqesin kërkesat e tyre në procedurën e likuidimit dhe paditësi pohon se brenda afatit të paraparë ka paraqitur kërkesën e tij për paga të papaguara. Paditësi ka pohuar se referimi i Autoritetit të Likuidimit në dispozitën ligjore nga neni 608 i LPB-së paraqet zbatim të gabuar të ligjit material pasi që kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar me nenin 196 të Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) dhe refuzimi i kërkesës bazuar në këtë dispozitë është inekzistente. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa e paditësit, të anulohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN092-0160 i datës 28.08.2013, të detyrohet AKP dhe AL që në emër të pagave të papaguara t'ia paguajë paditësit shumën e borxhit kryesor prej 15.000 euro si dhe kamatën prej 3.5% prej ditës së vonesës deri në fillimin e likuidimit, ndërsa kamatën prej 8% prej ditës së likuidimit e deri në pagesën përfundimtare, gjithashtu të detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të tarifës së OAK-së për hartimin e padisë në vlerë prej 104 euro si dhe të gjitha shpenzimeve tjera deri në fund të procedurës. Ankesës ia ka bashkangjitur njoftimin e AKM-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 01.06.2006, Vendimin e AL-së PRN092-0160 të datës 28.08.2013, kopjen e listës së llogaritjes së dëmit në emër të kompensimit të bonave të mëngjesit dhe të regresit të paditësit, vendimin nr. 433/4 të datës 06.08.2001 për kompensimin e dëmit për punëtorët e larguar me dhunë nga puna në vitin 1990.

Me datë 02 mars 2016, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar drejtë. AKP-ja pohon se paditësi pretendon se nuk ka pranuar pagën e tij prej vitit 1991 prandaj ky ishte momenti kur ai kishte të drejtën procedurale të parashtroj ankesë ndaj NSH-së pranë gjykatave të rregullta të asaj kohe. AKP ka pohuar se letra e marrëdhënies së punës e cila përmendet nga paditësi ka të bëjë vetëm dhe ekskluzivisht me krijimin e listës së shpërndarjes së 20% të privatizimit të ndërmarrjes. Tutje AKP ka pohuar se vendimi i pranimit të kompensimit të punëtorëve është i nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm i NSH-së i cili nuk ka asnjë autoritet të marrë përsipër detyrime në emër të NSH-së. Edhe po të ishte i mirëqenë vlefshmëria e këtij dokumenti, ky është lëshuar në vitin 2001 pra 11 vite pasi paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin e tij. Andaj kërkesa e paditësit është e parashkruar. AKP ka kërkuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 18 mars 2016, paditësi dorëzon përgjigjen në mbrojtjen e AKP-së në të cilën përsërit pretendimet e tij të dhëna në padi.

Me datë 31 gusht 2016, AKP ka parashtruar kundërpërgjigjen e saj me të cilën ka pohuar se paditësi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që do të mbështeste pretendimin dhe as që ka arritur të kundërshtoj ndonjë prej argumenteve juridike listuar në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 24 janar 2023, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, në të cilën pohon se është invalid i luftës së UÇK-së. Bashkë me kërkesë paditësi dorëzoi kopjen e librezës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, vendimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile me të cilën shihet se gëzon pensionin e invalidëve të UÇK-së në vlerë prej 127.40 euro.

Me datë 26 janar 2023, shkalla e parët e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-2115 e aprovon në tërësi si të bazuar kërkesën e paditësit për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

Me datë 04 prill 2023, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-2115 (2022:272792), e refuzon si të pabazuar padinë e paditësit si dhe e vërteton si të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN092-0160 të datës 28.08.2013. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kompensimi i pagave i referohet viteve 1990-1991, ndërsa kërkesa për kompensimin e këtyre pagave është bërë me 03.08.2007. Neni 376 paragrafi 1 i LMD-së në mënyrë shprehimore përcakton se "kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar përshkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin", andaj në bazë të kësaj dispozitë gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa e palës paditëse për kompensimin e pagave për vitet 1990-1999, është parashkruar ngase është parashtruar pas kalimit të afatit ligjore prej 3 viteve.

Me datë 02 maj 2023 (përmes postës) paditësi (në tekstin e mëtejme ankuesi) dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS C-IV-15-2115 të datës 04.04.2023, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore. Ankuesi ka pohuar se bazë e kërkesës së tij për kompensim kundër NSH-së është përjashtimi i tij nga puna në vitet e 90-ta për shkak të diskriminimit nacional ndaj punëtorisë shqiptare nga ana e Serbisë në ekonominë e Kosovës dhe i cili diskriminim është vërtetuar edhe me dokumente të shumta të OKB-së. Tutje ankuesi pohon se gjykata nuk ka bërë shqyrtimin e asnjë fakti edhe pse palët në parashtrësit e tyre kanë këmbyer argumentet në lidhje me procedurat gjyqësore në këtë rast, dhe në vend se të caktoj një seancë dëgjimore ka zgjedhur të hesht. Ankuesi pohon se gjykata gabimisht i referohet nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së, pasi që ankesa e ankuesit nuk ka të bëjë me dëmin por me pagat e papaguara. Tutje paditësi ka pohuar se nuk mund të flitet për kurrfarë parashkrimi e dëshmon edhe jurisprudenca e DHPGJS-së, në rastet kur punëtorit i është lëshuar Letër Pezullimi atij nuk mund ti refuzohen kërkesat nga arsyeja e parashkrimit. Ankuesi në ankesë përmend disa raste të zgjidhura nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, mbi të cilat pretendon se duhet ti njihet e drejta e tij. Ankuesi kërkon nga gjykata që çështjen ta kthej në rigjykim dhe të thërrasë palët në një seancë dëgjimore, të caktoj një ekspert i cili përmes ekspertizës do ta caktonte saktësisht vlerën e kompensimit të pagave për periudhën 1990-1999 dhe përkatësisht të merr Aktgjykim me të cilin do të

miratohet në tërësi ankesa e ankuesit, të shfuqizohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe çështja të kthehet në rigjykim, të obligohet e paditura që në emër të kompensimit të pagave për ndërprerje joligjore të marrëdhënies së punës t'ia paguajë ankuesit shumë prej 27.641.95 euro për periudhën 1990-1999 duke përfshirë kamatën prej 2.764.19 euro. Gjithashtu ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore të përfaqësimit në bazë të Tarifës së OAK-së, padia në vlerë prej 104 euro dhe ankesa në vlerë prej 208 euro, si dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në fund të procedurës.

Ankesës ia ka bashkangjitur: kopjen e librezës së punës, Njoftimin nr. 364 të datës 29.09.1991, Vendimin për pushim vjetor nr. 261 të datës 29.05.2001, vendimin për pushim me pagesë nr. 286 të datës 04.07.2003, vendimin për vazhdimin e kontratës të punës të datës 20.06.2006, pasqyrën e llogarisë së Trusit për periudhën 01.08.2002-13.04.2023, vendimin për kompensimin e dëmit për punëtorët e larguar me dhunë nga puna në vitin 1990 nr. 433/4 të datës 06.08.2001, një Urdhëresë për kalkulimin e kompensimit të dëmit nr.549 të datës 19.10.2001, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 01.06.2006.

Me datë 22 qershor 2023, ankuesi ka dorëzuar një kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Këtë kërkesë e mbështet në faktin se është veteran i luftës së UÇK-së, duke pohuar se e ka dorëzuar dëshminë në shkallën e I-rë.

Me datë 03 korrik 2023 (përmes postës) AKP-ja e ka dorëzuar përgjigjen në ankesën e ankuesit me të cilën thekson se Aktgjykimi i shkallës së parë i DHPGJS-së është i bazuar në ligj dhe se ai duhet të konfirmohet. AKP-ja ka pohuar se qëndrimi i palës kundërshtarë lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshëm i sqaruar në mbrojtjen e parashtruar pranë shkallës së parë, dhe përsëritja e tyre do të jetë e padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, andaj ka kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat, dhe në arsyetimin ligjor andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 03 gusht 2007, ka paraqitur një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 27.641.95 euro për periudhën 1990-1999. Kjo kërkesë është refuzuar si e pavlefshme nga ana e Autoritetit të Likuidimit, me arsyetimin se e njëjta është parashkruar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e refuzuar kërkesën e paditësit duke arsyetuar se kompensimi i pagave i referohet viteve 1990-1991, ndërsa kërkesa për kompensimin e këtyre pagave është bërë me 03.08.2007. Neni 376 paragrafi 1 i LMD-së në mënyrë shprehimore përcakton se "kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar përshkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin", andaj në bazë të kësaj dispozitë gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa e palës paditëse për kompensimin e pagave për vitet 1990-1999, është parashkruar ngase është parashtruar pas kalimit të afatit ligjore prej 3 viteve.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, dhe ato të sjella gjatë procedurës ankimore, pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe me konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së ai ka sjellë mjaftueshëm prova që dëshmojnë se ishte punëtorë i NSH-së, mirëpo ai nuk ka sjellë ndonjë dëshmi tjetër për të vërtetuar se ai më parë i ka kërkuar këto paga në gjykatën kompetente, për të mos lejuar parashkrimin e kërkesës.

Është e qartë se paditësi as gjatë procedurës ankimore nuk ka sjellë në gjykatë ndonjë dëshmi që pagat e kërkuara për periudhat e cekura, i ka kërkuar më parë në organet kompetente, brenda tri viteve.

Paditësi kërkesën për këto paga e ka paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit vetëm me datë 03 gusht 2007, tek Autoriteti i Likuidimit, që tashmë është tepër vonë dhe kërkesa konsiderohet e parashkruar, në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit konsideron që Njoftimi i ish AKM-së i datës 01.06.2006 për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 04 shkurt 2006 që është sjellë në gjykatë, nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, pasi që parashkrimi ka ndodhë më heret para se të pranohet ky njoftim.

Paditësi ka pasur mundësi që nga viti 1990 t'i kërkojë pagat e pretenduara ndaj NSH-së, e të mos lejojë të ndodhë parashkrimin e kërkesës që tashmë veçse kishte ndodhur.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet refuzuar si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi në bazë të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që në bazë të nenit 8 pika 8.1.4. i njëjti i takon kategorisë së invalidit të luftës së UÇK-së.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_